

Bazuar në nenin 17 paragrafi (7) të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/14, 199/14, 27/16, 35/18 dhe 198/18 dhe "Gazeta zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 143/19 dhe 14/20) dhe nenit 34 paragrafi 1 paragrafi 7 të Ligjit për qasje të lirë në informacione me karakter publik (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 101/2019), Drejtori i Agjencisë për Mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informacione me karakter publik, më 12.02.2021, solli

R R E G U L L O R E
për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për sistemimin e vendeve të punës
në Agjencinë për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në
Informacione me Karakter Publik

Neni 1

Kjo Rregullore ndryshon dhe plotëson Rregulloren për sistemimin e vendeve të punës në Agjencinë për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informacione me Karakter Publik, (numri i aktit bazë 01-439/2, datë 06.10.2020).

Neni 2

Në pjesën IV. Përshkrimi i vendeve të punës në Agjencinë për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informacione me karakter publik, në pikën 3. Njësia për TIK - teknologjitë e informacionit dhe komunikimit, në pozicionin e punës 10. Bashkëpunëtor i ri për përditësimin e bazës së të dhënave, Kodi UPR 01 01 B04 000 , në rubrikën lloji i arsimit, fjala: "ose" ndryshohet me presje dhe pas fjalës "elektroteknieri" shtohen fjalët: "ose inxhinieri telekomunikacioni".

Neni 3

Në pjesën IV. Përshkrimi i vendeve të punës në Agjencinë për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informacione me karakter publik, në pikën 5. Sektori për bashkëpunim, transparencë dhe arsim, nën-pika 5.1. Njësia për Marrëdhënie me Publikun, Transparencë dhe Edukim, pas pozitës 30. Konsulent për Përkthime, UPR 01 01 B01 000, shtohet pozita e re: "30-Bashkëpunëtor i ri për Marrëdhënie me Publikun - PR".

5. SEKTORI PËR BASHKËPUNIM, TRANSPARENCË DHE EDUKIM	
5.1. Njësia për marrëdhënie me publikun, transparencë dhe edukim	
Numri rendor	30-a
Shifra	UPR 01 01 B04 000
Niveli	V4
Titulli	Bashkëpunëtor i ri
Emri i venbdit të punës	Bashkëpunëtor i ri për marrëdhënie me publikun – PR
Numri i realizuesve	1
Përgjigjet para	Udhëheqësit të Njesisë për marrëdhënie me publikun, transparencë dhe edukim
Lloji i arsimit	Shkenca politike ose administrata dhe administrata publike
Kushte tjera të posaçme	/

Qëllimet e punës	- Kryerja e detyrave më të thjeshta rutinore të punës në lidhje me informimin e publikut për veprimtarinë e Agjencisë dhe promovimin e konceptit të aksesit të lirë në informacionin e disponueshëm publik.
Detyra dhe obligime për punë	<ul style="list-style-type: none"> - ndihmon në kryerjen e aktiviteteve të përcaktuara në programin e Departamentit; - ndihmon në redaktimin dhe përditësimin e faqes së internetit të Agjencisë; - merr pjesë në përgatitjen e lajmeve, informacioneve, raporteve dhe njoftimeve për ngjarje të rëndësishme, trajnime të mbajtura, punëtori dhe aktivitete të tjera të Agjencisë. - ndihmon në përgjigjen e kërkesave të parashtruara për informacione të disponueshme publike që i posedon Agjencia; - ndihmon në organizimin dhe mbajtjen e konferencave për shtyp; - ndihmon në shkrimin e informacionit për media; - ndihmon në përgatitjen e broshurave, publikimeve, buletineve dhe literaturës tjetër promovuese të lëshuar nga Agjencia; - merr pjesë në përgatitjen e një strategjie komunikimi dhe përgatit raporte për zbatimin e saj.

Neni 4

Në pjesën IV. Përshkrimi i vendeve të punës në Agjencinë për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informacione me karakter publik, në pikën 5. Sektori për bashkëpunim, transparencë dhe arsim, nën-pika 5.1. Njësia për Marrëdhënie me Publikun, Transparencë dhe Arsim, pozicioni me numër rendor 31. dhe titulli i pozitës Bashkëpunëtor i ri-Përkthyes, kodi UPR 01 01 B04 000, në rubrikën Numri i përmbaruesve, numri "1" zëvendësohet me numrin "2". .

Neni 5

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit dhe do të zbatohet pas marrjes së pëlqimit nga Ministria e Shoqërisë Informative dhe Administratës.

**Drejtore
Pllamenka Bojçeva**